Pa. nr. 08-111

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga CROATIA osiguranje d.d., me seli në rrugën Vatroslava Jagiça nr. 33, Zagreb, Kroaci, dhe AV International GmbH, me seli në Muthgasse 27, 1190 Vjenë, Austri, nëpërmjet Jasmina Brezovska, avokate nga Shoqëria e Avokatëve „BONA FIDE“ nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 17.08.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi, me të cilin CROATIA osiguranje d.d., me seli në rrugën Vatroslava Jagiça nr. 33, Zagreb, Kroaci, dhe AV International GmbH, me seli në Muthgasse 27, 1190 Vjenë, Austri, do të themelojnë një shoqëri të përbashkët, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Ligji), më datë 15.07.2026, ndërsa e plotësuar më datë 24.07.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës u dorëzua njoftimi për përqendrim nga CROATIA osiguranje d.d., me seli në rrugën Vatroslava Jagiça nr. 33, Zagreb, Kroaci, dhe AV International GmbH, me seli në Muthgasse 27, 1190 Vjenë, Austri, me të cilin CROATIA osiguranje d.d. dhe AV International GmbH do të krijojnë një ndërmarrje të përbashkët.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe dokumentacionit të bashkëngjitur, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira

CROATIA osiguranje d.d. është shoqëri tregtare, veprimtaria kryesore e së cilës është sigurimi dhe risigurimi.

Përveç kësaj, nëpërmjet ndërmarrjeve në pronësi të CROATIA osiguranje d.d. (në vijim: „Grupi CROATIA"), në tregun gjeografik të Kroacisë, si dhe në Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, krahas veprimtarive të sigurimit dhe risigurimit, ushtrohen edhe veprimtaritë e mëposhtme: administrimi i fondeve pensionale, kryerja e kontrolleve teknike të automjeteve, ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe veprimtaritë e pasurive të paluajtshme.

CROATIA osiguranje d.d. është në pronësi shumicë të shoqërisë ADRIS GRUPA d.d., me seli në Rovinj, Obala V. Nazora 1, Kroaci, veprimtaria kryesore e së cilës është administrimi dhe investimi, nëpërmjet kësaj shoqërie, ajo është e pranishme në tregjet e turizmit, prodhimit të ushqimit të shëndetshëm, sigurimeve dhe energjetikës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, CROATIA osiguranje d.d. është e pranishme në tregun e sigurimeve nëpërmjet dy ndërmarrjeve të saj të lidhura, mbi të cilat ushtron kontroll të drejtpërdrejtë, përkatësisht:

- CROATIA OSIGURUVANJE SHA Shkup – Shoqëria për Sigurimin e Jetës Shkup, me adresë në rrugën Zhelezniçka nr. 41, 1000 Shkup;
- CROATIA OSIGURUVANJE SHA Shkup – Shoqëria për Sigurimin Jo-Jetësor Shkup, me adresë në rrugën Zhelezniçka nr. 41, 1000 Shkup.

AV International GmbH është shoqëri tregtare që vepron si shoqëri ndërkombëtare holding dhe shërbimesh në kuadër të grupit AVAG Holding SE (në vijim: „AVAG").

AVAG Holding SE është një nga grupet kryesore tregtare të automobilave në Evropë, me fokus në koordinimin dhe mbështetjen administrative të rrjetit të auto salloneve jashtë Gjermanisë.

AV International GmbH është nën kontrollin e drejtpërdrejtë dhe në pronësi 100% të AV Holding International, e cila, nga ana e saj, është nën kontrollin e drejtpërdrejtë dhe në pronësi 100% të AVAG Holding SE. AV International GmbH administron veprimtaritë ndërkombëtare të AVAG Holding SE nëpërmjet një rrjeti ndërmarrjesh nën kontroll shumicë në Austri, Kroaci, Slloveni dhe Hungari.

AV International GmbH nuk është e pranishme në tregun gjeografik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka shoqëri të lidhura në këtë treg.

Përqendrimi konsiston në themelimin e një ndërmarrjeje të përbashkët (joint venture), e cila në baza afatgjata do të ushtrojë veprimtari si një njësi ekonomike autonome. Ndërmarrja e përbashkët synon themelimin e një subjekti që do të operojë në tregun kroat dhe veprimtaria kryesore e të cilit do të jetë riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve motorike.

Ndërmarrja e përbashkët nuk do të ushtrojë veprimtari dhe nuk do të realizojë të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës,* vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:
Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ